VENDIM
Nr. 32, datë 26.3.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË "ALBPETROL" SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", neneve 9 dhe 13 pika 1 germa "d" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa "g", nenit 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pikat 1 germa "a" dhe 3, të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.3.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Albpetrol" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Albpetrol" sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

-Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar pjesërisht. (Mungon ekstrakti i QKR-së).

-Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar pjesërisht (Mungon vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj institucioneve të sigurimeve shoqërore).

-Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10 pikat "a" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Ndërsa për pikën "b" të këtij neni, subjekti nuk ka dhënë informacion.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë "Albpetrol" sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani